



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3748 / 7 Prot.

Patos më 24.12.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 17.12.2025

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Klaudio Alisinanaj
2. Liljana Mesutaj
3. Erald Çepele
4. Lori Musaj
5. Artan Velçani
6. Klarida Semanjaku
7. Armand Ahmetaj
8. Ertilla Myrtaj
9. Suela Hoxha
10. Smerald Hazizaj
11. Elmira Rama
12. Renaldo Shpata
13. Vjollca Kasaj
14. Novrus Toska
15. Gani Ahmetaj
16. Shezai Sinanaj
17. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

I nderuar Kryetar,

Jemi në mbledhjen e këshilit bashkiak e cila bazohet në nenin 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe nenit 59 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak.

Pjesmarrja në mbledhje është 17 këshilltarë.

Në seancën e sotme siç e keni vënë re kemi një rend dite që përfshin shqyrtimin e projektbuxhetit, dokumentin themelor që orienton politikat financiare dhe zhvillimin e njësisë sonë vendore.

Ky proces kërkon përgjegjësi institucionale, transparencë dhe një diskutim të matur e konstruktiv. Roli i Këshillit është të ushtrojë kompetencat e tij ligjore duke garantuar që fondet publike të përdoren në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe në shërbim të interesit të qytetarëve dhe të njësive administrative.

Ftoj të gjithë anëtarët e Këshillit që debati të zhvillohet në përputhje me ligjin dhe rregulloren, me argumente profesionale dhe respekt reciprok, në mënyrë që vendimmarrja që do të marrim të jetë sa më cilësore dhe në interes të komunitetit.

Dua tju informoj se rendi i ditës është ndërtuar në zbatim të rregullave që përcaktohen në ligj dhe rregulloren e këshillit po ashtu dua tju informoj që çështjet kanë kaluar në shqyrtim në komisionet përkatëse të cilat kanë opinionet e tyre dhe do ta shprehin gjatë mbledhjes.

Paraprakisht dua tju pyes nëse keni ndonjë çështje që doni ta shtoni apo ta hiqni nga rendi i ditës
Erald Çepele- unë kisha vetëm një propozim lidhur me projektvendimin numër 7 projektbuxheti përfundimtar 2026 propozoi që ta kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës sipas ka problematika që do të diskutojmë dhe do tna mari kohë kështu që propozoi ta kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

Arman Ahmetaj - ne nuk na pengon asnjë gjë që ta shqyrtojmë atje ku është dhe nuk kemi pse ta lëvizim në kohën e kemi dhe e kemi marrë parasysh, nuk merret parasysh

Erald Çepele- Unë bëra një propozim

Armand Ahmetaj- ok nuk merret parasysh kemi ndonjë tjetër po nuk merret në zbatim të rregullores nuk mund ta marrin parasysh sepse është projekt buxheti dhe unë sapo fola, duhet një argument më i thelluar për të na thënë që, tani unë kam kohë të gjithë kanë kohë prandaj kanë ardhur.

Erald Çep tele- Ku e bazon këtë gjë, në kë nen të rregullores, Hidhe në votim

Armand Ahmetaj- Çfarë të hedhim në votim

Erald Çepele- Ndryshimin e rendit të ditës.

Armand Ahmetaj- po si e ndryshojmë këtë gjë

Erald Çepele- ndryshohet në baze të rregullores dhe ligjit

Armand Ahmetaj-pse ta kalojmë në fund, çështjet që kalojnë për shqyrtim në fund janë ato çështje që propozohen jashtë rendit të ditës ato që janë në rendin e ditës ne e kemi vendosur që të shqyrtohen në këtë pozicion që janë.

Erald Çepele- këshilltarët e kanë në dorë të ndryshojnë rendin e ditës.

Armand Ahmetaj- po të ndryshojnë rendin e ditës nëse ke ndonjë çështje që nuk është vendosur në rendin e ditës

Erald Çepele- këtë çështje unë propozoi që ta lëmë në pikën e fundit?

Armand Ahmetaj - Erald të lutem duhet ta kuptosh mirë,

Erald Çepele- të lutem respekto rregulloren ti ke të drejtë ta hedhësh në votim propozimin e këshilltarit kaq.

Armand Ahmetaj- Unë duke u bazuar në kompetencat e kryetarit të këshillit nuk e hedh në votim sepse kërkesa është e padrejtë. Kemi ndonjë kërkesë tjetër?

Armand Ahmetaj- Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 27.11.2025.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 27.11.2025.

4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin nëntor 2025".

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2025".

6- Projekt-vendim "Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026".

7- Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028".

8- Projekt-vendim "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor 2027".

9- Projekt-vendim "Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2025-2026".

10- Projekt-vendim "Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studime në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026".

11- Raporti performancës për bashkinë Patos për vitin 2025.

12- Informacion mbi Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kush është dakord me rendin e ditës ?

Miratohet me 16 vota pro, asnjë abstenim, 1 kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Klaudio Alsinonai




Penelopa Shyrate

Leni Musaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3748 / 8 Prot.

Patos më 24 .12.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 27.11.2025

Armand Ahmetaj –Keni ndonjë verejtje ndonjë sygjërim për ndryshimin e procesverbalit?
Konsiderohet i miratuar.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Kludio Arshonaj

Renaldo Shyato

Lori Mosej

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3448/9 Prot.

Patos më 24 12.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 27.11.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 27.11.2025 u morën gjithsej 5 vendime nga nr. 74 deri në 78 .

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 76 i është përcjell Prefekturës dhe ka ardhur përgjigja se vendimi është në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

Klaudio Alismani

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Renaldo Shpota
Lori Musaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3785/ Prot.
3

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin nëntor 2025”.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 79 datë 10.12.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin nëntor 2025”.

Spektori i Shërbimit Social propozon Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Nëntor 2025 gjithsej 23 familje me një fond prej 104,702 (njëqind e katër mijë e shtatëqind e dy) lekë.

Klaudio Alisinanaj - Në cilësinë e sekretarit të komisionit - Komisioni u mblodh dhe pasi shqyrtoi projektvendimin për ndihmën ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë e miratoi me katër vota pro propozimin e ekzekutivit pa asnjë ndryshim.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin nëntor 2025”.

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

Klaudio Alisinanaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Refaela Shyreta
Lori Musaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2786 / Prot.

3

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2025”.

Mitjon Nikolla – Projektvendimi nr. 80 datë 10.12.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2025”.

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Nëntor 2025 gjithsej 14 familje me një fond prej 44,648 (dyzetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë) lekë.

Klaudio Alisinanaj - Dhe për këtë projektvendim Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar komisioni e miratoi me katër vota pro propozimin e ekzekutivit pa asnjë ndryshim.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin nëntor 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Klaudio Alisinanaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Refaela Xeba
Lori Musaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr 3743/13 Prot.

Patos më 24.12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026”.

Çajup Refitaj – Sot jemi me projektvendimin mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 në këtë material taksat ngelen të pandryshuara në raport me paketat e mëparshme që nga periudha 2021 flasim këtu për taksë ndërtesë taksë trualli taks tabele dhe taksa të tjera që janë të përfshira në këtë material ngelen të pandryshueshme ashtu sikurse dhe përcaktimet ligjore që kornizojnë apo përcaktojnë këto taksa ndërsa lidhur me pjesën e tarifave dhe ato ngelen përsëri në nivelet e paketave të mëparshme duke mos pësuar asnjë ndryshim natyrisht tek pjesa e tarifave duke qënë se është një pjesë e shërbime që ofrohet nga vetë bashkia Patos këtu janë përcaktuar dhe modalitetet duke ndërtuar dhe strukturën e secilës prej familjeve taksapagusit familjarë po ashtu edhe pjesës së biznesit mbi bazën e objektit të aktivitetit të gjithsecilit prej tyre duke i marrë këto në konsideratë është vendosur dhe pesa specifike për gjithë për secilin nga këta taksapagues.

Ky është siç e përmenda dhe pak më sipër pas vitit 2021 është po e njejta strukturë e cila qëndron në të njejta nivele si ato që kanë qënë në raport me këto vite pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar në konjekurat e tregut në raport kryesisht me shërbimet e tregut që ofrohen jemi përsëri në nivelet që janë përcaktuar në paketat e mëparshme.

Nuk e di nëse do ishte me interes që të shprehëshim në mënyrë të detajuar apo materiali është trajtuar dhe konsideruar nga ana juaj dhe të futemi në pyetje direkte.

Klaudio Alisinanaj - Për projektvendimin mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 dhe këtë e studioi komisioni dhe patëm shumë diskutime dhe pyetje në fakt ku patëm dhe sqarimet dhe trajtimin të duhura nga ekzekutivi si përfundim votuam me 3 vota pro dhe një abstenim kështu që u miratua si projektvendimin në komision ajo që do thoja unë ishte që përderisa nuk pati dhe ndryshime pasi siç e tha dhe ekzekutivi është e pandryshuar nga viti që kaloi ne bëmë disa propozime për nga mënyra e ndërtimit të materialit në fakt jo se prekte as nivelin e tarifave të taksave vendore thjesht nga mënyra e ndërtimit të saj disa propozimet tona që mendoj që duhet të reflektohen në zbardhjen e procesverbalit apo të projektvendimit të pas miratimit nëse miratohet kështu që ne si komision e miratuam.

Armand Ahmetaj – Këto propozime i kemi në procesverbal besoj, në procesverbalin e mbledhjes. Çajup Refitaj- Propozimet e komisionit kanë qënë lidhur me tabelën 1,1 lidhur me pjesë në tarifave për aktivitetet e transportit pra ato që zhvillohen me automjete duke i klasifikuar ato në transport udhëtarësh dhe transport mallrash tabela 1.1 është në vazhdim të tabelës 1 dhe ne mendojmë që duke qënë se është e qartë mendojmë të ngelet e pandryshueshme.

propozimi tjetër i komisionit kishte të bënte me tarifat

Armand Ahmetaj- Çajup të lutem që ta kuptojmë prek thelbin e paketës .

Çajup Refitaj- jo nuk e prek thelbin

Armand Ahmetaj- Atëherë nëse e prek thelbin janë pasqyruar në procesverbal

Kryetari Bashkisë- në momentin që do të dorzohet projektvendimi i miratuar, nëse do të miratohet në Prefekturë do bëhen ndryshimet përkatëse.

Armand Ahmetaj- ok se nëse do kishte ndryshime në thelb kerkohet procedurë shumë herë më të gjatë dhe nuk mund ta shqyrtojmë sot fare ndaj e bera dhe pyetjen

Çajup Refitaj - një ndërhyrje nuk ishin themelore po janë gabime në mënyrën e të shprehurit

Kryetari i Bashkisë - gabime ortografike.

Lori Musaj - përshëndetje të gjithëve doja të merrja këtë fjalë në të cilësine e kryetares së komisionit të ekonomisë pavarësisht se nuk kam mundur të jem prezente në mbledhjen e komisionit të zhvilluar ditën e djeshme por jam njohur me materialin paketa fiskale që paraqitet sot për shqyrtim dhe miratim nuk përmban ndryshime krahasuar nga ajo e vitit kaluar duke garantuar cilësinë në vijmësinë e politikave fiskale dhe stabilitetin financiar të njësisë qendrore.

Nga shqyrtimi rezulton se paketa është qartë e zbatueshme dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në këtë kuadër duhet të përgëzojë ekzekutivin për punën e kryer dhe përgatitjen e një paketë të qëndrueshme fiskale dhe realiste duke qenë se nuk ka ndryshime thelbësore vlerësoi se miratimi i saj do të sigurojë vazhdimësi dhe stabilitet në administrimin në të ardhurave vendore për këtë arsye si kryetare e komisionit ekonomisë e mbështesë paketën fiskale dhe ftoj kolegët ta miratojnë.

Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim "Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord ?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Klonda Alsinonaj



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Penelopa Shpata
Lori Musaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr 3651 Prot.
13

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028”

Mimoza Shtëmbari - vijmë sot me projektvendimin për miratim të buxhetit për vitin 2026 dhe dokumentin përfundimtar të buxhetit afatmesëm 26-28 i cili përmban edhe numrin e përgjithshëm të miratuar me vendimin e këshillit të bashkisë në muajin nëntor. Projektbuxheti për vitin 2026 vjen pas një punë shumë mujore e cila është materializuar në dy dokumentat e parë faza e parë dhe faza e dytë në shtator dhe vjen sot me dokumentin përfundimtar me projektvendimin i cili shoqërohet me relacionin e detajuar me tregues financiarë me ndërhyrjet me zgjidhjen e problematikave dhe realizimin e projekteve sipas prioriteteve të bashkisë

Në projektvendimin e paraqitur janë detajuar të gjitha burimet dhe shpenzimet ku buxheti për 2026 është i balancuar i shoqëruar me tabelat shoqëruese të cilat janë të miratuara nga sistemi i menaxhimit të buxhetit vendorë nga ministria e Financave.

Relacioni përmban të gjithë treguesit objektivat dhe prioritetet e bashkisë të cilat sipas treguesve financiarë në mënyrë të përmbledhur të relacionit që shoqëron projektvendimin.

Burimet për vitin 2026 buxhetin të bashkisë Patos përbëhen nga të ardhurat vjetore që zënë vlerën 328 milion e 632 mijë lekë ose në përqindje 45%, transfertë e pakushuar e cila zë vlerën 248 milion 672 mijë lekë ose në përqindje 34% dhe ajo sektoriale që zë vlerën 156 milionë 534 mijë lekë ose 21% të buxhetit në total

Në total buxheti për vitin 2026 me 3 burime që janë objekt i miratimit me vendim të këshillit bashkiak zë vlerën 733 milion 839 mijë leke. 733.839.281 lekë.

Po ta vëmë në raport peshën specifike që zë në këtë total buxheti me të ardhurat ne jemi në një rritje të mbulimit të buxhetit nga të ardhurat e bashkisë me një vlerë 45% ndaj totalit dhe në këtë raport në këtë buxhet total vlen të theksohet që peshën më të madhe për në rritje e zënë investimet me 27% të vlerës totale të buxhetit duke i referuar klasifikimit të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik kemi këtë raport në buxhetin e vitit 2026 52 % shpenzimet e personelit 19.6 % operative gati 1% zë fondi rezerve dhe i kontigjencës dhe si thash edhe më lart investimet vlerën 27%.

Duke ju referuar dhe i krahasuar buxhetin e vitit 2026 me buxhetin e vitit 2025 sipas burimeve fillestare këtij klasifikimi ekonomik që përbën buxhetin e bashkisë kemi një rritje prej 9.02% nga transfertat e pakushtëzuar në fazën përfundimtare nga faza e shtatorit kemi 15% të transfertës të pakushtëzuar dhe 5.13% rritje të të ardhurave lokale.

Mbas miratimit të fazës së dytë të shtatorit është bërë ndryshimi dhe buxhetuar shtesa e cila është buxhetuar dhe mbulon koston për shpenzimet e personelit për transfertën sektoriale që mbulon funksionin e mbrojtjes nga zjarri shpëtimin arsimi bazë, i mesëm, menaxhimin e pyjeve dhe ujitje kullimi.

Po ti referohemi buxhetit sipas relacionit shoqërues të buxhëtuar sipas programeve është viti i parë që bashkia patos është një bashki pilot dhe futet në 12 bashki e pilotuara që nga 17 programe që është punuar dhe buxhetuar për vitin 2025 të kalojnë me gjashtë programe, të gjitha këto programet mbulojnë 36 funksione dhe kanë të kostuar 36 funksionet që sipas ligjit 139 mbulon bashkia.

Këto janë treguesit kryesorë, pastaj duhet të përmendim edhe një herë që investimet përqindje investimeve është në një rritje në një përqind nga viti 2025 dhe objektet për investime dhe prioritare të cilat janë buxhetuar dhe janë me financim një vjeçar dhe 3 vjeçar sipas projekteve janë të listuara në materialin shoqërues që shoqëron projektvendimin.

Projektet që kanë dalë prioritare dhe nga gjithë identifikimi në terren janë:

Rikonstruksioni i bllokut para pallatit të kulturës vetëm për 2026 48 milion 304 mijë lekë.

Rikualifikimi urban sheshi përpara ish bashkisë 84 milion 299 me financim 2026-2028

Rikonstruksioni i blloqeve të banimit në lagjen 1 maj 192 milion 25-27.

Në vazhdim nga 2025 dhe 2026 një vlerë për investime e patrupëzuar po që i shërben projekteve dhe opionencave që do cdo projekt dhe studimeve që nuk i bën bashkia.

Rikonstruksioni i rrugës Manxhari Gjyngarë

Rikonstruksioni i rrugës Argjaturata Beline

Rikonstruksioni i rrugës Rilindje Belinë

Përmirësimi i paketave të shtresës asfaltike Heronjtë e Linasit, Shpiragu degëzimi i rrugës Sulo Goxhaj i cili është i miratuar me VKB gjatë vitit 2025 është futur në buxhetin e 26 dhe është 2025-2026 financim

Rikonstruksioni aneksit të stadiumit të Patosit me vite financimi 2026- 2027.

Krijimi parkut të re kreativ me financim 25-27.

Rikonstruksioni shkollës Sotir Capo dhe ndërtimi palestres i cili është një investim me një projekt të fituar në Ministrinë e Arsimit me bashkëfinancim 85% me 15 % bashkia.

Rikonstruksioni i kopshtit numër 2 i cili finalizohet në 2028 është me financim 26-28 ndërtimi i kuartallit të ri të varrezave 26 – 28 ndërtimi i kabinës me parametra 20 kilovat 26-27 përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet e varfërara dhe të pafavorizuara është një projekt që e kemi fituar 25 vazhdon financimi dhe për 26 është me bashkëfinancim 70% Ministria dhe 30% ne,

Në një listë të shoqëroni dhe relacionin janë edhe investimet që janë në proces përfundimi nga pushteti qendror.

Kemi pastaj rikonstruksionin e rrugëve të brendshme të bllokut vresht rikonstruksionin e kopshtit me drekë i cili finalizohet në 2026 ndërtimi shëtitores faza e dytë rikonstruksioni i bllokut përpara pallatit kulturës, përmirësimi i kushteteve dhe komuniteteve të pa favorizuara e cila do jetë në vazhdim prioritet për ato familjet të cilat do të identifikohen sipas pikëzimit të miratuar nga këshilli dhe me projektet kjo do të shpallin nga thirrjet nga Ministrit përkatëse.

Në vazhdim të relacionit për çdo investim më keni ndërhyrje që bëhen dhe grupet përfituese për çdo investim në çdo objekt të cilat shoqërojnë projektvendimin në relacion.

Gjithashtu ky projektbuxhet prek dhe anën sociale me aktivitetet që mbulon Shërbimi Social si dhe projektet kulturore artistike të cilat janë zhvillojnë gjatë gjithë vitit dhe janë pjesë e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm.

Ky është materialit dhe relacionin në mënyrë të përmbledhur shoqëruar projektvendimi është relacioni më i detajuar me nivel aktiviteti dhe produktit.

Klaudio Alisinajnaj- Komisioni edhe këtë projektvendim pas diskutimeve të shumta në fakt se normalisht buxheti është projektvendimi më i rëndësishëm për 2026 pas diskutimeve që patën në komision pas gjitha përgjigjeve që morem nga ekzekutivi si nga ekonomike si nga ana e të ardhurave të shpenzimeve të investimeve pra të gjithë buxhetin si përfundim dakordësuam me dy vota pro dhe një abstenim kështu që e miratuan si projektvendim.

Unë dua të marrë fjalën edhe si kryetar i komisionit të ligjeve në këtë rast si anëtar i këshillit për zonën në lagjen e Re meqë është dhe sipas kalendarit mbledhja e fundit që zhvillojmë vetëm po patëm ndonjë mbledhje jashtë radhe dua të jap përgëzimet e mia për ekzekutivin për vitin 2025 për

zonën që unë mbuloj pastaj janë bërë nderhyrje shumë të rëndësishme pjesa më e mirë është e lagjes së re zona e vreshtit atje ku janë mbuluar pothuajse të gjithë rrugët me asfaltbeton gjithashtu punime të shkëlqyera ka patur me ish agjencinë se tani është bërë ndërmarrja e shërbimeve publike të cilat kemi patur nderhyrje si përroi cam apo trotuar ndricim dhe gjithë të tjera kështu që përgëzime për të gjitha punimet që janë bërë në 2025 gjithashtu dhe shumë suksese për 2026 pasi janë shumë projekte të rëndësishme siç është parku rekreativ aty që do ti shërbejë zonës jashtëzakonsht shumë mua për hir të vërtetës kryetar mu duk e ulët ajo vlera e projektit është shpresoj që të ketë diçka me të vërtetë shumë të bukur atje se janë dy zona realisht që kanë ngelur pak mbrapa si zona a dhe zona b që ishin sqaruar në project pasi unë e di shumë mirë ku janë zona e ish fushës së zeze dhe zona poshte tek përroi jam i sigurt se që ky do të shërbejë shumë zonës atje dhe është project me shumë rëndësi apo investimi siç është dhe para sheshit ish bashkisë nga ishte një investim me rëndësi edhe pse projecti me sa më thanë dje nuk është gati akoma po prapë është me interes gjithashtu pastaj dhe ato që kishim menduar blerje baz materiale siç janë ndërtimeve ujrave të zeza dhe të bardha apo bazë materiale për ndriçimin dhe për të gjitha punimet që të bëjmë tashmë me ndërmarrjen e shërbime publike kështu që urime për 2026 urime më të mira nga unë si anëtar këshilli dhe së dyti pastaj për të gjithë kolegët se normalisht është dhe siç e thashë mbledhja e fundit e këtij viti përgëzime të gjithë bashku për gjithë vitin që kemi kaluar në 2025 për të gjithë punët që kemi bërë si në mbledhjet e këshillit dhe si në komisionet pasi realisht të gjithë ne e dimë që kemi qënë pjesë shumë aktiv atje kemi pasur plot diskutime madje dhe propozime për ndryshime dhe gjithë të tjera kështu që urime më të mira për ju për gjithë vitin që lam pas dhe sukseset gjithë së bashku dhe për 2026 dhe për dy projektvendimet që janë më të rëndësishme si për buxhetin dhe për paketën fiskale edhe njëherë faleminderit dhe suksese.

Smerald Hazizaj- dhe unë e kam shprehur votën time pro në komision 2 por disa gjëra më duhet ti them dhe sigurisht që qytetarët presin një sqarim.

Kryetar i vetmi problem që cilit i kap të gjitha zonën Rersin Patosin Margëllicin por dhe më gjerë është linja e transportit publik që për hir të së vërtetës sot ka dy muaj dhe në këtë projekt buxhet unë nuk e pash një investim të tillë për mjetin e transportit që ne bëm një punë shumë të mirë e mbuluan pothuajse për një vit e ca me mjetin që kishte por nuk e pashë në projekt buxhetin e 2026 blerjen e një automjeti që do të bëjë këtë shërbim e dyta prap e njejtja që i kap të të gjitha njësitë është rruga Patos- Patos i Vjeter, dje nga ekzekutivi për hir të së vërtetës për fatin e keq ndoshta nuk e kuptova unë por uroj që mos të jetë kështu pamë vetëm rrugën Patos - Patosi vjetër pa e lënë mënjane këtu fshatin Margëllic.

Tani të hidheni pak më ngushtë në zonat kryetar unë e pas në plan kishte rrugën e kalasë ishte diçka për tu përgëzuar se fundja fundja ata qytetarë kanë vite që nuk e shikojnë një investim normalisht investim dhe ndriçimin por ngela pa par rrugën e Pëllumbave ose Hoxhajve

Unë do të kërkoj ndejsë në fillim se unë po i them me emra ose me fise si janë se ndoshta në dijenin timin nuk e kanë akoma një emërtim të saktë ato rrugë po besoj se bashkarisht i kemi shkelur dhe jemi të qartë kur flasim nëse diçka nuk po e kupton unë jam i gatshëm ta sqaroj kemi dy familje aty të cilët janë për fatin e keq të tyre familje kanë invalid dhe e kanë të detyruar daljen në rrugën kryesore.

Po në fshatin Margëllic kemi një rrugë sa ndahet midis Patosit Vjetër dhe Margëllicit është një rrugë që të con poshtë përsëri pra te Hoxhallarëve ose më saktë te Bajrami te Luani flasim këtu për rrugë që janë segmente dhe jo rrugë të mirëfillta flasim këtu jo më shumë se një gjatësi 150 m deri ne 200 m linear.

Po ashtu unë nuk pash dot një investim në këto tre vite për fatin e keq pa cka se oficina është pak si e menjanuar po nuk është mënjeluar me Kasnicën që për hir të së vërtetës ka marrë një investim shumë të lartë nuk e kemi në Oficinë një projekt ose një rrugë të cilët ose një segment rrugës të jëtë projektuar dhe të jetë në buxhet qoftë në këtë vit qoftë në viteve në 2026.

Kemi nisur në lagjen Reres rrugën Paja ose Xhelaj kemi mbyllur një fragment shumë mirë në lagjen Karamanajve po e kemi lënë pa ndricim.

Ajo që më gëzoj pamase ishte rruga e Buzajve segment shumë i vështirë si nga ana e infrastrukturës po ashtu dhe nga ana e terrenit që me të vërtetë një investim shumë shumë i domosdoshëm për atë banorë që janë atje dhe të dyja këto fshatrat kryetar më lejo të them që janë në të vetmet fshatra të qytetit që nuk i janë larguar ose të kenë migrantë ose të kenë ikur në Patos apo në Fier kjo është edhe për diçka për një jetese më të mirë dhe unë besoj se këta e kanë të domosdoshme dhe atë rrugë që kanë, këto nuk janë rruga për më shumë për segmente.

Nuk na ngelët gjë tjetër ti kërkojmë ndjesë për gjithë kohën e humbur atyre qytetarëve dhe banorëve të lagjes dhe uroj shpresoj shumë që janari të gjej mjete në Mustafa Matohiti të dyja rrugët që janë shumë shumë të domosdoshme dhe diçka tjetër që këtu është paksa që e lidh të gjitha rrugët përfshi dhe me rrugën kryesore të Oficinës vjetër Patosi i vjetër është një nga segmentet bujqësore edhe industriale ajo rrugë sepse atje shtrin dhe kompanitë Terra oil në mos gaboj dhe Albpetroli kanë pusët e veta por kjo zone po kthehet në një zonë bujqësore dhe ashtu si unë jam i bindur dhe sigurt që jeni në dijeni sepse i keni shkelur dhe vetë dhe me mua bashkërisht që ajo është një zonë që atyre u shërben relativisht banorëve Patosit Vjetër Margëllcit, Oficinës dhe pse jo dhe Ruzhdies dhe Rerësit.

Dhe atje nuk janë aspak as shumë kanë burime të jetësës së familjeve tyre që e kanë lidhur ngushtë me këtë lloj fruit, atje janë rreth tridhjetë mijë ullinj dhe ajo rrugë është domosdoshmërisht për tu bërë dhe të ishte planifikuar.

Përsa i përket Mustafa Matohitit ka disa segmente rrugës për tu bërë të cilët janë të domosdoshme aty, segmenti i parë është ish kopshti ose ku janë lapidarët sot, por dhe një segment që ne e kemi pasur dhe një problematikë dhe unë e di që disa qytetare e kanë ngritur problematikën e ujërave dhe bashkia është në dijeni që atje ka qenë një zonë që shket dhe investimi dhe kanalizimet e rrugës po flas për segmentin e rrugës ish reparti ushtarak ai segmenti i shkurtër lart që të vijë gjithë ujërat e malit atje poshtë dhe ajo rruga akoma dhe banorëve po ja bën jetesën të paqëndrueshme.

Duhet të dalë këtu jashtë projekt buxheti po përmënds këtu dhe dy problematika shumë të mëdha të cilët e lidhin e mar këtë fjalë po e them për ta dëgjuar dhe instancat e tjera pse jo dhe bashkia ta referoj ne pothuajse e mbyllim këtë vit buxhetor por e mbyllëm pa mjek ajo zonë atje ka afërsisht janë tre fshatra të cilët e kanë akoma mjekun të domosdoshëm por jo efektiv atje.

Me iniciativën tuaj këtu kryetar dhe përfshi edhe drejtorinë e arsimit vetëm për vitin kalendarik të 2025-2026 që filloi tani ka pasur një në shkollën Mustafa Matohiti as më pak e as më shumë vetëm 35 veta të cilët ka marrë shpërnguljen dhe janë transferuar nëpër shkolla private apo shtet nje hemoragji të cilën po e vret lagjen po e vret aq shumë sa hera herës ndonjëherë po na duket sikur po mbaron jetesa atje edhe unë nuk do të doja ashtu. Iniciativa nëpërmjet pushtetit vendor, ZVA Patos dhe më gjerë dhe e juaja konkretisht nëpërmjet stafi pedagogjik që shërben atje se të hedhësh një miliard lekë dhe të shikosh që ajo shkollë të shkoj drejt përfundimit është shumë e dhimbshme.

Këtu do gjetur ajo hallka se cilët janë arsyet që këta nxënës se nuk ikën njeri për qejf ikën sepse diçka mungon, mungon nga ZVA mungon nga pushteti vendor apo ikin nga stafi pedagogjik.

Atëherë kishin problematika të cilët unë po i preka dhe i thashë por sigurisht që prisnin dhe një reagim dhe në fund fare do them diçka dhe për projektbuxhetin.

Erald Çepele – Problematikat do ti fokusoj do hyj direkt në teme, nuk kam asgjë me paketën fiskale sigurisht që duhet gjetur mekanizmat e duhur që ne ti motivojmë qytetarët që të paguajnë akoma më shumë taksa por kjo gjë nuk më rezulton në njesinë administrative Zharrës ku unë dua të flasë konkretisht sot dhe do të adresoj problematikën që kam adresuar dhe më herët por që...

Unë duhet të bëja dy ndërhyrje këtu tek plani investimeve për ndërhyrjet për vitin 2026 dhe konkretisht të fillojmë nga investimet rikonstruksioni blloqeve të banimit në lagjen 1 Maj, vlera përcaktuar për vitin 2025 është 16 milion e 900 mijë, 80 milion në 2026 dhe 124 milion që shkon si investim 221 milion ose 2 miliard e 200 milion lekë të vjetra vetëm për rikonstruksionin e bllokut të lagjes 1 Maj.

Nuk ka më asnjë gjë me asnjë lloj investimi përkundrazi më vjen mirë për kolegun Klajdin që përmendi lagjen e Re është bërë një investim që mund të ketë kushtuar bashkisë në dy vitet e fundit rreth 100 milion lekë të reja unë kam vërejtjet e mia që për mua nuk mund të ishte bërë aq të ishte

zgjatur ajo pedonale deri diku që nuk ishërben kërkujt mund të pastrohesh kanali të bëhet pjesë pjesë, ky është mendimi im unë mendoj që shpenzimet duhet të jenë të balancuara.

Kryetari Bashkisë- Në momentin që hyn në vlera normalisht vlerat duhet të jenë reale jo të marrim vlera që ti themi kot të marrim hamendësime për sa i përket lagjes së Re janë bërë dy investime.

Për sa i përket investimeve që janë bërë në lagjen e Re unë i kërkoj ndjesë banorëve të lagjes së Re që janë bërë pjesë e letrave të hapura ne facebook pasi çdo investim që është bërë në lagjen e Re ata e meritojnë.

Në lagjen e Re janë bërë dy investime, investimi parë është segmenti i parë në pjesën jugore të lagjes së Re .

Erald Çepele- Me fal, unë nuk bëra pyetje për investime në lagjen e Re. E krahasova. Nuk më inereson fare si punë.

Kryetari Bashkisë- Për sa i përket lagjen e Re janë bërë dy investime, 1 është bërë në 2023 dhe është me vlerë 24 milion lekë dhe tjetri është bërë në 2025 dhe është me vlerë 33 milion lekë, me tvsh. Për sa i përket perroit është bërë investim nga emergjencat civile nga fondi që është për emergjencat civile, duke qënë se ata që banojnë në lagjen e Re e dinë sesa problem ka qënë ai perroi dhe vlera e te gjithë investimit i perroit në lagjen e Re segmenti parë ka qënë 6 milion e 400 mijë lekë dhe është bërë nga punonjësit e bashkisë.

Erald Çepele janë marrë te fondi Shqiptar i Zhvillimit materialet

Kryetari Bashkisë- Çfarë materialesh janë marrë te fondi Shqiptar i Zhvillimit

Erald Çepele – Blerja e bazës materiale, pse duhet të shkojnë të gjitha në një, duhet të shpërndareshin, mund të shkonin diku tjetër, ka dhe zona tjera

Kryetari Bashkisë- Ku e di ti si është aplikimi që është bërë te fondi Shqiptar i Zhvillimit, ca ka këtu.

Erald Çepele – Në momentin që kemi hedhur kaq lekë në një investim duhet ta kishim shpërndarë atë

Kryetari Bashkisë- Nuk janë ashtu shpërndarjet , nu shpërndahen ashtu si thoni ju.

Erald Çepele – Nuk mund ta hedh buxhetin në një investim të gjithë, për çfarë jemi ne këtu , ne përfaqësojmë komunitetin, projektbuxheti nuk bëhet ashtu.

Kryetari Bashkisë- Po si bëhet

Erald Çepele – Shpërndahet

Kryetari Bashkisë- Për sa i përket fjalës së këshilltarit të facebook duhet ti kërkoj ndjesë dhe z. Qani Redhi duke qënë se këshilltari akuzoi dhe ata që bëheshin pjesë e dëgjësave të Zharrzës, që tha vijnë të njëjtit njerëz që nuk ka pse i paragjykon. z. Qani ka qënë një nga pjesëmarrsit më të rregullt të të gjitha dëgjësave që janë bërë një njësinë adm Zharrëz, i vlerësoj shumë të gjitha ato ankesa që janë ngitur, e njehta gjë mund të them dhe për Ladin që është lart. Ndërsa këshilltari i facebook nga 26 dëgjesa që janë bërë vitin e fundit ka qënë vetëm në 3 dëgjesa. Nga ato 3 dëgjesa në 2 ska folur fare, në dëgjesën e tretë ka folur për taksat dhe një ditë të bukur dimri kujtohet që në njësinë adm Zharrëz që ai nuk banon aty se nuk banon aty? Apo banon?

Erald Çepele – 70% e administratës ty nuk të banon në Patos, se po ta kalojmë personale, të lutem të mbaroj fjalën unë. Unë kam folur në emër të qytetarëve. Kërkesat e mia janë publike, le ti mohoj Qaniu dhe ata që kanë qënë në dëgjesa publike që këto investime nuk egzistojnë në Zharrëz. Ti më kanalizove mua qytetari digital unë kam platformën time që unë marr komunikim me qytetarët, mar kërkesat nga qytetarët, nëse ju doni ti trajtoni ok nëse nuk doni nuk ke pse merresh me mua personale nuk jam unë problemi, nëse jam unë problemi jap dorëheqjen që tani në këto monente dhe le ti përfaqësojnë të tjerë njerëz qytetarët. Unë kam mënyrën time që, ti mund të thuash çfarë të duash unë e kam dritaren time të hapur i marrë kërkesat dhe i shpreh qartë ato që mar. Lagjja e Re shumë mirë që u bë ato punimet cilësie dobët atje si në kohën e komunizmit, bëhen punime me bëton e tezga, punime skandaloze kështu që unë kam vërejtjet e mia meqë dashkeni kështu.

Vazhdojmë me rikonstruksionin e kopshtit nr. 2 me vlerë 45 milion lekë të reja dhe për këtë unë kam vërejtjet e mia. Asnjë projekt nuk është bërë këtu që të financohet nga Minsitria, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pse do ti marrim gjithë këto kosto vet?

Kryetari i Bashkisë- Ministria e Arsmit nuk investon në kopshte, as Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsmit investon në shkolla mos dizifermo ose mund të pyesësh.

Erald Çepele – Thash nuk ka mundësi që të financohet nga institucion tjetër nga ndonjë organizatë e huaj?

Kryetari i Bashkisë- në momentin që bëhet nga ndonjë oranzitatë e huaj duhet të hapet thirrje.

Erald Çepele – ok se qënkam unë problemi, nuk ka rëndësi se janë gurë për kokën tuaj këto. Rikualifikimi urban pranë bashkisë një sqarim për këtë vlera është 84 milion sheshi para bashkisë.

Kryetari i Bashkisë- në 2028, është 2028- 2029

Erald Çepele – nuk e kam të vlera e projektit e kam se ai shesh është bërë para disa vitesh cfarë do ti bëni atij sheshi me 70-80 milion lekë?

Kryetari i Bashkisë- është për 2028, ska as projekt

Armand Ahmetaj- Erald eja i përgatitur në mbledhje.

Erald Çepele – mos mu kundërvini tani se do them një shprehje tjetër.

Armand Ahmetaj- Ti mund të thuash ca të duash po fol me baza ligjore.

Erald Çepele – keni parashikuar në 2026 blerje asfalto beton për shtrim rrugësh në vlerën 30 milion të reja , unë dua një shpjegim nga kjo vlera 30 milion lekë të reja sa janë parashikuar konkretisht për rrugët e Zharrzës? Se kemi një listë në fund te prioritetet e bashkisë që ka qënë dhe vjet dhe parvjët edhe në kohën kur ishte kryetare parë kanë qënë disa rrigë nga këto dhe nuk janë bërë . Tani unë propozoj që ky 30 milion lekë të ndahet sa i takon Zharrzës për këtë pjesë. Dhe një pyetje të fundit sa ka kontribuar Zharrëza në 2023, 2024 dhe 2025 deri në 11 mujor në taksa dhe tarifa sa janë të ardhura totale dhe sa janë shpenzimet? Ky është një diskriminim që i bëhet këtij komuniteti dhe unë nuk mund ta pranoj më këtë lloj, ju vazhdoni votoni si koleg nëqoftë se unë jam e keqja e kësaj atëherë do marim veprime të tjera të mëvonshme, unë pres një përgjigje dhe nuk e votoj këtë buxhet në këto kushte sic është.

Armand Ahmetaj- Dua tju njoftoj se Albiona Lamaj është prezente në sallë jemi 18 këshilltarë.

Albiona Lamaj- e para se këshilltar edhe kur të shprehim problematikat tona asnjëherë nuk është e drejtë që të bëjmë krahasime midis lagjeve pse kjo lagje ka këtë investim dhe kjo lagje nuk ka këtë investim sepse qytetarët janë gjithë barabartë dhe të gjithë kanë të drejtë që të kenë investimin, unë edhe si këshilltare e lagjes 1 Maj në projekt buxhet dua të shpreh përgëzimet edhe më vjen mirë që kjo lagje është parë me këto investim dhe atë që kuptova unë edhe në bazë të vlerës së investimit nuk është vetëm rikonstruksion është parë diçka më tej kësaj gjëje dhe nga ana sociale edhe pallateve dhe hapësirave që ka kështu që përgëzime për këtë pjesë të projekt buxhetit edhe e dyta do të jetë e mira që kërkesat që ne kemi dhe unë jam e bindur që ekzekutivi është në dispozicionin tonë përpara se të vijmë këtu dhe t'i bëjmë pyetjet në këshillë dyert e kemi të hapura që të gjitha këto pyetjet që për të tjerët nuk kanë ndonjë interes por është interesi personal i një zone apo këshilltari është e drejta që këtë informacionin e ka të drejtën ta marrin çdo ditë pranë bashkisë dhe të mos krijojmë këtë lloj debati edhe konflikti që krijohet këtu dhe së fundmi smarrim asnjë përgjigje dhe nuk kuptojnë asgjë as qytetarët por as vetë këshilltari

Elmira Rama- së pari do ta filloja duke kërkuar ndjesë për gjithë vitin 2025 për shqetësime që i kam krijuar qoftë administratës me telefonata me trokitje në zyrë dhe njëkohësisht edhe të falënderoj për përgjigjen edhe për bashkëpunimin, lexova me vëmendje projekt buxhetin u mundova ata kuptoj më sakte me qartë por gjithsesi kam disa paqartësi dhe për këtë do të drejtoj dy-tre pyetje së pari lista prioritare e projekteve të investimeve padyshim aty unë pash që ishin të listuara edhe investime për njësinë në administrative Zharrës por gjithsesi doja të dija përveç kriterit të projektit pra që është i gatshëm një projekt ose është i fituar a ka ndonjë kriter tjetër në përzgjedhjen e investimeve?

Pyetja e dytë në relacion është një listë prioritare të rrugëve dhe në listë është një numër i konsiderueshëm i rrugëve për njësinë administrative zharrëz sa mundësi reale janë për të realizuar ndërhyrjen në të gjitha këto rrugë apo dhe segmente se vura re që atje ka edhe segmente po kështu edhe tek lista e objekteve prioritare ishte për njësinë administrative Zharrës të planifikuara ndërhyrje por unë do të vecoja planifikimin për një sistem vaditës është një shqetësim i banorëve që unë e kam dëgjuar vazhdimisht edhe në disa takime e kam shtruar si çështje si problem dhe më vjen mirë që e lexoj në këtë por doja të dija a ka një projekt konkretë apo është thjesht një synim që do jeni në kërkim të një eksperti të mundshëm?

Lori Musaj - Në fjalën time nuk duhet të ndalem në investime konkrete siç diskutuan kolegët por buxhetin e vitit 2026 e shoh që paraqet elementë pozitiv dhe tregues të një planifikimi të kujdesshëm financiarë kjo tregon se investimet janë rritur me dy përqind çka tregon një fokus të shtuar drejt projektit zhvillimor dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimit të qytetarëve kjo rritje është një sinjal i qartë që orientimi drejt zhvillimit të qëndrueshëm akoma me e rëndësishme është fakti që bashki është në gjendje të përballojë rritjen e pagave të administratës dhe miratuara me vendim qeverie pa krijuar vështirësi i financiare dhe pa cënuar balancat e buxhetit kjo tregon përgjegjësi në menaxhimin e burimeve financiar dhe stabiliteton e financave vendore në kuadër të kësaj duhet të përgëzoj ekzekutivin për punën që ta bërë hartim e një buxheti realist të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm. Ftoj kolegët ta miratojmë

Kryetari Bashkisë – lista prioritare është si lista e dëshirave që ka bashkia apo qyeti për vitet e ardhshme. Përsa i përket mundësive konkrete është buxheti

Përsa i përket transportit Patos Patosi vjetër duke qënë se mjëti që kishim pësoi një difekt në fund të vitit ne nuk mund të bënim më hapa të mëtejshëm procedural për blerjen apo riparimin e tij pasi dhe riparimi ka një kosto të konsiderueshme por përsa i përket marrjes së një mjëti të ri transporti nëse asnjë nga privatët nuk do shprehi interes për linjën Patos Patosi Vjetër që deri më sot nuk ka pasur interes nga ndonjë kompani apo nga ndonjë person fizik do shohim për muajin janar kur të bëhet pjësa e fondeve të trashëguara pasi nëse do fusnim dhe blerjen e një mjëti të ri transporti do kishte disbalancë dhe nuk do konsiderohej më buxhet i shëndoshë.

Përsa i përket rrugët që ju përmëndët rrugët e oficinës dhe rrugër Patos- Patos lart përsa i përket vlerës së investimeve bësoj se shkojnë në një vlerë nëse ato do bëhën brenda 1 viti shkojnë në një vlerë jashtëzakonisht të konsiderueshme jo vetëm për një buxhet bashkie por mbase dhe me shumë për 2 buxhete ne bashki pasi vetë vlera e projektit të bërë si projekt i rrugës Patos Lagjja Mustafa Matohiti e kalon vlerën e 100 milion lekë të reja duke shtuar dhe rrugën e oficinës dhe rrugën Hoxhaj dhe rrugën Pellumaj kjo është vlerë shumë e ulët, këto që janë rrugë kryesore kalojnë vlerën e investimit që ka mundësi bashkia për një vit me buxhetin e saj, besoj se shkojnë te dy vite investime ndërsa i përket rrugës Xhelaj do të shtohet shumë shpëjt nuk besoj se do vonohet, rruga Buzaj është në planifikim por do vlerësohet njëherë edhe vlera sa do jetë te preventivi i rrugës Buzaj ndërsa për sa i përket ndicimit te rruga Karemanaj është planifikuar për vitin tjetër ku do mbyllim dhe një numër të konsiderueshëm rrugësh me ndricimi rrugor në vitin e ardhshëm. .Përsa i përket rrugës së dyqaneve Rrapushaj janë të palnifikuara të dyja për tu bërë dhe sic e thamë. Përsa i përket e lagja e Re që e ngriti Klajdi përsa i përket fushës së zeze është mbyllur projekti i rikonstruksionit të rrugës se ish fushës së zezë ndërsa pjesa b e projektit që është parku rekreativ është një vlerë parashikuese në fakt por nuk është se ne e kemi një vlerë fikse se sa do jetë pas hartimit të projektit që po bëhet nga të tretet. Por besoj se vlera nuk do të jetë shumë e lartë si projekt nga vet mënyra e ndërtimit të parkut se një pjesë e punimeve trotuari , perroi nuk do kenë nevojë të futen në projektin e parkut rekreativ pasi janë bërë. Do ta shohim me fondet e trashëguara në janar, fusha e zeze është e sigurt që do të bëhet muajin tjetër. Persa i përket parkut nuk mund tju them me siguri se varet nga vlera që do të vej, ne e kemi parashikuar një vlerë të caktuar nëse ajo do të jete e mjaftueshmë ai do të bëhet vitin e ardhshëm. Përsa i përket ndërhyrjeve që janë bërë në lagjen e Re kur është bërë projekti në fillim për përroin nëse ato do bëheshim me te trete vlera e 400 m të para të përroit do të shkonte 36 milion e 700 mijë lekë ndërkohë që ne e kemi bërë me 63 milion leke të vjetra dhe pagat e bashkisë për një muaj. Atje kanë punuar 20 punonjës me page nga 40 mijë lekë deri në 51 mijë lekë kanë punuar për 1 muaj, pagën e mnovratorët dhe karburanti.

E vetma gjë që kemi dëmtuar atje është fauna. Të njëjtën gjë përsëri me punonjësit e bashkisë kemi ndërhyrë në përroin Dukas që mbyllëm segmentin e parë dhe atje është bërë përsëri e njëjta mënyrë investimi duke blerë bazën materiale dhe duke i bërë punimet me punonjësit e bashkisë, të njëjtën gjë kemi bërë dhe një Gjyndaqarë që muret që janë në atë lagje po bëhen nga punonjësit e bashkisë cdo gjë është bërë për efekt kosto pasi në qoftë se ne do përdorinim për cdo investim që është bërë nga ana e bashkisë qoftë dhe për investime në rrjet Kuz apo në sheshe sic do bëhen dhe 2 stacionet e pompimit në Sheqishte, punimet do bëhen nga punonjësit e bashkisë e gjitha jo për efekt kosto duke ulur ndjeshëm koston e cdo investimi të bërë nga bashkia. Nëqoftë se ne këto investime do ti bënim me të tretë ne nuk do bënim as 1/100 e atyre investimeve pasi duke marrë të gjitha sheshet e pallateve që janë bërë në Patos dhe që do bëhen në Zharrës nuk do dilte buxheti as për 3 vite të cilat janë bërë me kosto minimale nga punonjësit e Ashp-se të cilët i falenderoj.

Per çka foli Mira ne kemi aplikuar në disa projekte në Ministrinë e Bujqësisë për pjesën e vadistjes në njësinë adm Zharrëz dhe për pjesën e sistemit të një pjesë të konsiderushem të kanaleve kullues. Në njësinë adm Zharrës për vitin tjetër është e parashikuar rruga e Rilindje e Belinës, projekti është përfunduar, cdo projek që bëhet infrastrukturor dhe ndërtimor kërkohet oponenca, oponenca na ka kërkuar një studim gjeologjik të tokës që do vendosët më pas për disa ndryshime që do kemi në projekt. Kjo është një vlerë që është parashikuar për vitin e ardhshëm është një nga rrugët më problematike të në njësinë adm Zharrës është dhe rruga e argjinaturës në Belinë që është parashikuar të fillojë në buxhetin e vitit 2026. Ndersa një investim aktual që është duke u bërë në Në njësinë adm është në shkollën Sotir Çapo. Vlera në buxhetin e bashkisë është 28 milion lekë, 5 milion e 600 mijë është për këtë vit dhe pjesa tjetër është për 2 vitet e ardhshme. Gjithshtu janë dhe disa segmente të tjera në Në njësinë adm që janë të parashikua për blerjen e bazës materiale. Ato kanë ardhur me një list rrugës që është parashikuar baza materiale e nevojshme për të shtuar këto rrugë dhe ato janë te relacioni buxhetit që kanë qënë kur është miratuar në buxhet në vitin 2024. Përsa i përket taksave të njësisë adm Zharrëz në vitin 2023 njësia adm Zharrëz ka pagaur 12 milion e 351 mijë e 305 leke taksa dhe tarifa në 2024 ka paguar 15 milion 133 mijë 194 lekë në 2025 18 milion 62 mijë e 5 lekë. Që është e dyta nga pesha që ka në buxhetin e bashkisë Patos. Pesha më e madhe e Albetrolit është taksa e objekteve që nuk janë fare në Zharrës por në Patos. Përsa i përket Bankersit është vlera që paguan për ndotjen mjedisore dhe për gjithë pjesën tjetër të taksave që shkon në 35 milion lekë dhe kjo vlerë kur kam ardhur unë si kryetar bashkie kishte 2 vjet që nuk ishte paguar dhe me pagesën që bëri Bankersi ne parashikuam rrugën Rilindja në Belinë. Renta për këtë vit është 30 milion lekë nga 75 milion lekë që është e parashikuar por renta minerare është për gjithë bashkinë nuk është për njësinë administrative Zharrëz. Në njësinë administrative Zharrëz është pika që bëhet peshimi dhe gjithë procedura që bëhet për pagesën e rentës pasi nuk prodhon Patosi naftë më shumë se Roskoveci pavarësisht se ne e kemi rentën më të madhe se ata. Më shumë prodhon Roskoveci po pika e shitjes është Patosi më saktë është në njësinë administrative Zharrëz që kështu renta nuk është e njësisë administrative Zharrëz. Njësia administrative Zharrëz ka pikën e shitjes por në asnjë moment ne nuk prodhojmë nafatë me shumë se Roskoveci apo Kucova etj. Kështu që renta nuk mund të hyj këtu në përllogaritjen e në mos gabo 10 milion euro të munguara në njësinë administrative Zharrëz kur vetëm për vitin e ardhshëm në njësinë administrative Zharrëz janë të parashikuara 200 milion lekë të reja investime.

Erald Çepele- 90% i mer vetëm shkolla është nga ministria se vetëm ajo shkollë ka ngelur se shkollat e Patosit janë bërë.

Renta shumë mirë e thatë ju që është pika e shitjes po aty shkarkohen dhe ndotja për banorët e zonës, aty janë dhe pusët e naftës, nuk ka Patosi puse naftë ka vetëm objekte

Kryetari Bashkisë- dy puse i ke këtu mbrapa

Erald Çepele- Ja dhe 4 në oficinë dhe 2 në kuqar, 6 puse kështu që aty lëvrohet gjithë ndotja e mjedisit që shkaktohet në njësinë administrative Zharrëz dhe Marinëz sic e thatë dhe ju dhe nuk është është e drejtë kjo që ka dhe taksa dhe tarifa të tjera që vijnë dhe nga grantet kështu që të gjithë e kanë thënë që është rreth 100 milion leke të reja në vit që i takojnë Zharrës përfshirë rentën, taksat, mjedisin, ndotje mjedisi 36 milion që jep bankersi dhe të tjera. Unë i kam përfshirë të gjithë taksën e tokës të ndërtesave kjo është në makro kryetar dhe unë pyetjen konkrete e kam sa janë investimet në këto 3 vitetë të fundit që i janë kthyer Zharrës?

Kryetari bashkisë- për vitin e ardhshëm në njësinë administrative Zharrëz 28 milion lekë janë të shkollës nga ana e buxhetit 50 milion leke është tek rruga e Rilindjes dhe 10 milion lekë është rruga e argjinaturës në Belinë plus dhe rrugë të tjera që janë parashikuar me blerjen e bazës materiale besoj se është një vlerë jo modeste për njësinë administrative Zharrëz.

Erald Çepele- Vlera për shkollën Zharrës është parashikuar në 23,099,607 lekë

Kryetari bashkisë- ca lidhje ka kjo?

Erald Çepele- Pse ka vajtur në 2027?

Kryetari bashkisë – Sepse është 3 vjet investimi atëherë përfundon. Edhe financimi nga ana e Ministrisë është për 3 vjet , 2025,2026,2027.

Erald Çepele- I bie 3 vjet pa arsim nxënsit.

Kryetari bashkisë- jo afati punimeve është 8 muaj, financimi është 3 vjet, nuk do rrinë fëmijët 3 vjet pa shkollë. Fëmijët vitin tjetër në shtator fillojnë shkollën atje ku ishin dhe vitin e kaluar.

Armand Ahmetaj – Erald në respekt të procesurës së bëre një kërkesë për të kaluar shpenzime nga njëri atëherë duhet të sqaroj pa të fryer se edhe unë nuk ta thashë si fyerje atë që thashë eja i përgatitur nëse e ke marrë si fryrje të kërkojë ndjesë.

Erald Çepele- unë nuk flas këtu si Erald por jam anëtar i këshillit, unë bëj një propozim që kjo vlerë i takon qytetarëve të Zharrës 30 milion lekë asfalto beton dhe të përcaktohet qartë jo të lihet evazive rrugë prioritare ka 3 vjet që ngelet listë prioritare, lista e babagjyshit thotë ai ku të dojë babagjyshi që të coj dhurata për vitin e ri.

Armand Ahmetaj – lutem tani më lër sqaroj për kërkesën që bëre sepse i nevojitet procesverbalit që do përpilohet kërkesa që kanë të bëjnë me vlera financiare që ta kuptosh duhet paraprakisht ose duhet gjithmonë të zbatohet ligji dhe rregullorja e këshill bashkiak atëherë përmend neni 91, 92 ,94 129 pra nëse ne do lëvizim një vlerë nga njeri shpenzim ose nga njeri objekt në objektin tjetër i bie që ndryshojmë krejt buxhetin dhe që ndryshohet krejt buxheti duhet të kesh një analizë të mirë financiare duhet të kesh një relacion që të jetë shterues.

Erald Çepele - kam kërkuar shumë thjesht pa pandryshuar destinacionin e gjëse, vlera 30 milion leke të përcaktohet në listën prioritare vetëm për rrugët e Zharrës. Jo të lihet asfalto betoni dhe pastaj të hidhet sipas dëshirave në rrugët e Margëllit.

Armand Ahmetaj – nuk merr parasysh propozimi ,është çështje procedure të lutem

Erald Çepele – ti ke të drejtë ta hedhësh në votim

Armand Ahmetaj – nuk e hedh fare në votim je në kundërshtim me rregulloren po të thëm

Erald Çepele – sjam fare në kundërshtim të relatohet të mbahet aty në procesverbal që kjo vlerën të shkoj vetëm për rrugët e Zharrës.

Armand Ahmetaj – neni 94 Projektaktet e paraqitura me iniciativë të Këshilltarit, Grupit Politik të Këshilltarëve, Komisionit të Përhershëm apo Komitetit të ngritur me vendim të Këshilli, dhe që kanë efekte financiare, duhet t'i kalojnë më parë për mendim Kryetarit të Bashkisë, i cili është i detyruar të shprehet me shkrim brenda 20 ditëve etj etj.

Tani të lutem prandaj ta thashë nuk ta thashë për të fyer dhe të kërkoj ndjesë në qoftë se je fyer eja më i përgatitur mbledhjen e këshillit dhe mos bëj kërkesa pa kuptim sepse na na çon ne qosokak

Erald Çepele - vetëm përcaktimi të jetë me listë ku do shkoj kaq, të përcaktohet qartë ku do shkoj ky 30 milion.

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028”

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, 1 kundër

Erald Çepelë lagohet nga salla

SEKRETARE

Refaela Xeba



Klenda Alsinani

Benedek Shyete

Lori Musaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 36521 Prot.
13

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor 2027”.

Mimoza Shtëmbari – Siç ju e dini është procedur ligjore është bërë e përvitshme në bazë të udhëzimit nr. 23 që me miratimin e buxhetit vjetor fillon dhe puna dhe hartimi i projekt buxhetit afatmesëm për vitet pasardhëse dhe vitit buxhetor pasardhës i vitit aktual që po miratojmë.

Ky projektvendim shoqërohet me relacion është përcaktuar baza ligjore, udhëzimi dhe me një shtojcë me një lidhje ku është gjithë kalendar i punës ku përcakton rolet dhe afatet për çdo aktor mbi përcaktimin e të ardhura edhe identifikimi në kërkesave paraqitjen e kërkesave miratimi në këshill të fazës së parë për miratimin e fazës së dytë miratimin e tavaneve përgatitore të tavaneve përfundimtarë deri në miratimin e buxhetit vjetor dhe përfundimtar dhe projektbuxhetit afatmesëm është një kalendar që ne punojmë gjatë gjithë vitit dhe ju jeni aktorë të zbatimit të këtij kalendar

Armand Ahmetaj- Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën tetë Projekt-vendim Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor 2027”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Klaudio Mësimanaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Penelopa Shute
Lori Musaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3746 / 13 Prot.

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nentë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2025-2026”.

Mitjon Nikolla – Projektvendimi nr. 77 datë 05.12.2025 “Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2025-2026”.

Numri i bursave për nxënësit e vitit të parë të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2025-2026 akorduar për Bashkinë Patos nga ministria e ekonomisë është 15 (pesëmbëdhjetë) bursa

Nga verifikimi i gjithë dokumentacionit të paraqitur në bashkinë Patos protokolluar por edhe asituar strukturat e bashkisë që gjithë nxënësit kishin mundësin që të grumbullonin gjithë dokumentacionin e nevojshëm u bë i mundur dorzimi i tetë aplikimeve nga nxënësit e shkollave të mesme profesionale pra 8 (tetë) aplikime nga 15 që kishim numrin e akorduar. Kam psur komunikim dhe me shkollat profesionale dhe më thanë që kaq është numri. Në këto kushte kur numri është me i vogël se numri i akorduar nga ministria i propozojmë këshillit të bashkisë të trajtojë me burse të plotë të gjithë nxënësit e shkollave të mesme profesionale që plotësojnë kriteret dhe kanë aplikuar.

Vjollca Kasaj- Komisioni i Arsimit shëndetësisë, rinis dhe sportet aplikimet për bursat për shkollat profesionale dhe duke parë edhe që numri i aplikantëve ishte më i kufizuar sesa bursat që kanë ardhur në dispozicion bashkisë Patos atëherë i miratuar me tre vota pro këtë projektvendim në komision ftoi edhe kolegët që ta votojnë

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën nëntë Projekt-vendim “Për miratimin e bursave të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin arsimor 2025-2026”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Klaudio Ahmetaj

Remelinda Shkote

Lori Musaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3747 / 15 Prot.

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studime në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026”.

Mitjon Nikolla – Projektvendimi nr. 78 datë 05.12.2025 “Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studime në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026”.

Bazuar në shkresën e ministrisë së arsimit mbi planin e bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2006 bashkisë Patos janë planifikuar 18 bursa theksoj se në kërkesën tonë kemi parashikuar 76 bursa drejtuar Ministrisë por numri i ardhur është 18 pasi ndahen në gjithë Shqipërinë.

Bëm gjitha njoftimet e duhura asistuaam përsëri gjithë nxënësit dhe prindërit e tyre që të grumbullonin dokumentacionin e duhuri e protokolluam pranë bashkisë të gjitha kërkesat i shqyrtuan dhe kemi 52 aplikime theksoj përsëri se 52 janë aplikime të plota dmth nuk ka asnjë mungesë dokumentacioni i vetmi fakt është numri i ultë i bursëve që kemi 18 bursa dhe për këtë kemi menduar që të propozojmë juve një përgjysmim të këtyre 18 bursave me qëllim kalimin në 36 gjysmë bursa dhe kështu do të mbulohen rreth 70% të apikantëve.

Klaudio Alisinanaj- krahasuar me vitin e kaluar si janë këto me ulje, me rritje apo njësoj?

Mitjon Nikolla- kemi 3 më shumë kanë ardhur 3 më shume.

Vjollca Kasaj - Komisioni Arsimit Shëndetësisë Kulturës Rinisë dhe Sporteve u ndodh edhe për të shqyrtuar edhe këtë projekt vendim faktikisht në u njohëm me të gjithë aplikimet numri aplikimeve ishte shumë i madh në krahasim me bursat që kanë ardhur 18 bursa nuk mund të plotësonin të gjithë kërkesat për ta kështu që ne u detyruam dhe shqyrtuam të gjitha rastet një për një dhe u detyruan të plotësojmë me gjysmë bursa 36 aplikime ato që ishin me kriteret më të domosdoshme që preknin kriteret e këtyre bursave psh kemi rastet kur një familje ka 3 fëmijë dhe janë me një prind i kemi dhënë 2 prej tyre dhe është një familje, 9 familje që kanë nga 2 nxënës me 1 prind, do të përfitojnë nga 2 gjysëmbursa dhe 11 familje që kanë nga 1 nxënës me 1 prind do të përfitojnë nga 1 gjysëmbursë, 1 nxënës me status jetimi që ka një prind do të përfitojë 1 gjysëmbursë, Ndërsa 4 gjysëmbursa do të shpërndahen për 4 nxënës që kanë problematika specifike sociale, bazuar në kriteret e VKM-së, të cilët janë nxënës me aftësi ndryshe dhe të braktisur nga njëri prind që është rasti i një fëmijë që është braktisur dhe e mbajnë 2 gjyshër të moshuar ose nxënës me status jetimi dhe humbje kujdestarie dhe njëri me prind invalid. Pra këto janë rastet që ne i kemi shqyrtuar i kemi përzgjedhur nga të gjithë rastet dhe prej tyre përfitojnë 36 gjysmebursa. Ne e votuam me tre vota po.

Albiona Lamaj – Për këta 16 që ngelen pa u shpërndarë kjo bursë nuk e do se pjesën ligjore unë nuk e njoh por mund të kemi ndonjë ndonjë mundësi nga ana e bashkisë që të mund t'i ndihmojmë këta 16 fëmijët ose këto që ngelen pak duke qenë se i plotësojnë dokumentacionet nuk kanë mungesë në dokumentacioni çfarë mund të bëjmë ne nga ana e bashkisë që të mund ti ndihmojmë edhe këta.

Mitjon Nikolla- Duhet parë mundësitë financiare të shikojmë me financën.

Renaldo Shpata - kisha vetëm diçka për këtë pikë duhet të pyesja për vlerën çfarë vlerë mbulon kjo bursa ?

Mitjon Nikolla- Sipas vkm është përcaktuar qartë vlera, gjysmëbursa do të shkoj në vlerën 3660 lekë edhe në përjashtim i vogli tatimit në burime diku te 3200 lekë por do të na vijnë vlerat dhe do ta kemi më të qartë kur të vij fondi total dhe do bëjmë ndarjen dhe shpërndarjen të llogaritë bankare të fëmijëve kjo është në gjithë shqipërinë kjo vlen .

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën dhjetë Projekt-vendim Për miratimin e bursave për nxënësit që ndjekin studime në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026 së bashku me propozimin e dakordsuar midis komisionit dhe ekzekutivit i cili sapo u shpreh nga kryetare komisionit të Arsimit ”.

Largohet Gani Ahmetaj

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Eldar Abdurrahman



Renaldo Shpata




Lori Musaj



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3748 Prot.
10

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Informacion mbi Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Klarida Semanjaku - përshëndetje kryetar unë do të falenderoja dhe si këshilltare edhe kryetare e aleancës së grave këshilltare dhe anëtare e komisionit barazisë gjinore për një shumë të vogël që ne të kërkuam për të vendosur në buxhetin e vitit që vjen për gratë viktimë të dhunës që ju e morët parasysh është një shumë modeste një shumë e cila në bashkëpunim edhe me drejtorinë përkatëse në vitin në vazhdim në bazë të rasteve të paraqitura do të vendoset në dispozicion të grave të cilat janë viktimë dhe për parandalimin e dhunës dua të falenderoj të gjithë ekzekutivin për punën përkushtimin për hartimin e buxhetit të vitit 2026 suksese dhe me punë të mira në shërbim të komunitetit

Armand Ahmetaj – dua të shpreh mirënjohje dhe falënderime pafund gjithë këshilltarëve pa përjashtim për të gjitha angazhimet që kemi pasur në vitin 2025 dhe jo vetëm por edhe ekzekutivit të bashkisë së cilin është gjendur në çdo situatë faleminderit për bashkëpunimin dua tju uroj që ju dhe familjet tuaja këto festa tju gjejnë të gëzuara dhe në zemrat plotë shumë faleminderit
Kryetari Bashkisë- Shpreh falenderime dhe urime për festat.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Klaudio Ahmetaj

Remelbo Shqeta
Lori Musaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3742 Prot.

Patos më 24 12.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 17.12.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njembdhjetë të rendit të ditës.

Raporti performancës për bashkinë Patos për vitin 2025.

Ina Sauli- Zv kryetare- Përshëndetje të gjithëve në cilësinë e kryetarit të grupit të njësisë së performancës është punuar për një raport për vitet 2021 deri në vitin 2026 për të gjitha drejtoritë dhe gjithë aspektet e punëve të bashkisë materiali është përfunduar dhe është pasuruar më të dhëna nga ana jonë por është duke u rishqyrtuar për pikat e fundit nga ekspert dhe do të jetë do të jetë gati ditën e nesërme i postuar në faqen zyrtare është thjesht informativ që mund të keni akses të gjithë për ta lexuar.

Shezai Sinanaj- Unë do të shpjegoj votën time që e dhash pro për buxhetin- dua të shpreh falenderim për ekzekutivin dhe kryetarin për punën e mirë që ka bërë në bashkinë e patosit po në vecanti për qytetin e Patosit dhe në vecanti për lagjen e vreshtit. Është kërkuar gjithmonë për tu bërë kjo punë dhe është bërë por destinacioni nuk ka qënë deri në ditën e fundit. Kryetari I ka shërbyer atij komuniteti shtëpi më shtëpi.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Klaudio Arinana

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Renaldo Shyeta

Lori Musaj Myd.